



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

**Njoftim**

**“Për kriteret që duhet të plotësojë kandidati për Rektor të Akademisë së Studimeve Albanologjike”**

Kandidati për Rektor të Akademisë së Studimeve Albanologjike duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Nenin 19 të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike” si dhe duhet të paraqesë pranë sekretares së KIZ, dokumentacionin e mëposhtëm:

g) kërkesën për kandidim, e cila përmban:

- emrin;
- atësinë;
- mbiemrin;
- datëlindjen;
- gjininë;

h) kopje të dokumentit të identifikimit;

i) kopje të noterizuar të titullit akademik;

j) dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar, vendin dhe vitet e punësimit.

k) shprehjen e vullnetit për kandidim;

l) formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ) për:

- deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
- mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit I bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
- deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrijnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

i) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor, jo më pak se 10 (dhjetë) vjet

j) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 (pesë) vjetësh.

**Kryetari**

**Hasan Bello**

